Në thelb, sistemi i kontrollit gramatikor mund të përmbajë një funksion kontrolli gramatikor që përdor kontroll gramatikor me bazë programi kompjuterik të përforcuar me redaktim njerëzor me popullsi burimesh për të analizuar dhe korigjuar një tekst të dhënë nga burimi për gabime gramatikore, ku burimi i jep funksionit të kontrollit gramatikor tekstin, funksioni i kontrollit gramatikor kryen analizë kontrolli gramatikor bazuar në programin kompjuterik mbi tekstin e marrë për gabime gramatikore, kalon pjesë të tekstit të dhënë nga burimi që përmbajnë gabime drejt së paku një redaktori (specialist i gjuhës shqipe) nga popullsia burim, duke menaxhuar përdorimin e së paku një redaktori (specialist i gjuhës shqipe) nëpërmjet mekanizmave algoritmike të kontrollit dhe i jep burimit tekstin përfshirë së paku një nëngrup të gabimeve gramatikore të identifikuar e të korigjuara. Burimi mund të jetë përdorues, mjet, program kompjuterik, e me radhë. Popullsia e burimeve mund të jetë popullsi burimesh në rrjet social, popullsi burimesh me autoritet, burim menaxhimi pune, individ, etj.

Në thelb, sistemi për mësimdhënien e përshtatur të gramatikës mund të bazohet në tekstin e dhënë në burim që përbëhet nga një bazë të dhënash rregullash gramatikore, ku çdo rregull gramatikor mund të lidhet me një përmbajtje reference të përgjithshme dhe me një shpjegim me gjuhë të thjeshtë; një motorr për përpunimin e tekstit të operueshëm për të zbatuar rregullat gramatikore në tekstin e dhënë nga burimi për të përcaktuar gabimet gramatikore; dhe komente të përbëra (të shtjelluara) për secilin gabim gramatikor, që përfshijnë përmbajtjen referente të përgjithshme dhe komente të përshtatura, ku komentet e përshtatura përfshijnë tekstin e dhënë nga burimi që ka sjellë gabimet gramatikore në shpjegimin me gjuhë të thjeshtë. Burimi mund të jetë përdorues, mjet, program kompjuterik, etj. Më tej, një program funksional përdoruesi me ndërfaqje mund të lidhet me motorrin e përpunimit të tekstit, programi funksional i përdoruesit me ndërfaqje i përdorshëm për t'i dhënë tekstin dhe komentet burimit.

Në thelb, sistemi i kontrollit gramatikor mund të përfshijë një motorr përpunimi të tekstit për të analizuar një tekst të dhënë nga burimi për gabime gramatikore dhe një bazë të dhënash prej një ose më shumë rregullash gramatikore, ku secili rregull gramatikor lidhet me përmbajtjen referente të përgjithshme dhe me një shpjegim me gjuhë të thjeshtë, dhe ku motorri i përpunimit të tekstit në funksion zbaton një ose më shumë rregulla gramatikore në tekstin e dhënë nga burimi për të përcaktuar gabimet gramatikore dhe, për çdo gabim gramatikor, kombinon komentet që përfshijnë përmbajtjen referente të përgjithshme dhe komentet e përshtatura, komentet e përshtatura kanë tekstin e dhënë nga burimi që ka sjellë gabimin gramatikor për t'u përfshirë në shpjegimin me gjuhë të thjeshtë. Burimi mund të jetë përdorues, mjet, program kompjuterik, etj. Procesi mund të kryhet në një mjedis kompjuterik "cloud".

Në thelb, metoda e kontrollit gramatikor mund të përfshijë sigurimin e një funksioni për kontrollin gramatikor të vendosur në pajisje kompjuterike (kompjuter) për të kontrolluar nga ana gramatikore një masë teksti të dhënë nga një burim, me qëllim përmirësimin e saktësisë gramatikore të tekstit; dhe lidhjen e një rregulli gramatikor nga një bazë të dhënash me rregulla me një përmbajtje referente të përgjithshme dhe një shpjegim me gjuhë të thjeshtë, ku motorri i përpunimit të tekstit në mënyrë funksionale zbaton një ose më shumë prej rregullave gramatikore në tekstin e dhënë nga burimi për të përcaktuar gabimet gramatikore dhe, për secilin gabim gramatikor, për të kombinuar komentet që përfshijnë tekstin referent të përgjithshëm dhe komentet e përshtatura, komentet e përshtatura përfshijnë tekstin e dhënë nga burimi që ka sjellë gabimin gramatikor në shpjegimin me gjuhë të thjeshtë. Burimi mund të jetë përdorues, mjet, program kompjuterik, etj. Gabimet e burimit mund të përdoren në një dokument të veçantë me qëllim mësimin e gramatikës, ku mësimdhënien transmetohet nëpërmjet paraqitjes së shpjegimeve duke përfshirë

në shpjegime tekstin origjinal të gabimeve në burim dhe duke marrë parasysh gabime të mëparshme të burimit në mbledhjen e një udhëzuesi referues të shkruarit të përshtatur për burimin. Udhëzuesi i të shkruarit mund të mos i referohet një teksti të caktuar. Përmbajtja e udhëzuesit të të shkruarit mund të zgjidhet bazuar në problemet specifike të të shkruarit në burim. Motorri i përpunimit mund të japë shpjegime për zhanrin/llojin e tekstit, kontekstin e tekstit, llojin e burimit, rolin/autoritetin e burimit, llojin e përdoruesit, rolin/autoritetin e përdoruesit, e kështu me radhë.

Në thelb, metoda e mësimdhënies mund të përfshijë ndarjen e një pjese teksti në skema; krahasimin e pjesëve të shkëputura me skema të njohura për të vlerësuar gabimet gramatikore në pjesën e shkëputur të tekstit; dhe paraqitjen e një udhëzuesi ndreqës në burim me shpjegime të gabimeve gramatikore që gjenden në pjesën e shkëputur të tekstit, ku udhëzuesi ndreqës përfshin tekstin e shkëputur në shpjegime, atë lloj teksti të vendosur mbi bazën e ngjashmërive mes skemave të shkëputura dhe atyre të njohura. Burimi mund të jetë përdorues, mjet, program kompjuterik, etj. Një ndërfaqje përdoruesi mund të sigurohet nëpërmjet së cilës burimi mund të vlerësojë cilësinë e udhëzuesit ndreqës. Udhëzuesi ndreqës mund të përfshijë lidhjen me gabime të mëparshme të bëra nga burimi.

Metoda e mësimdhënies mund të përfshijë ndarjen e një pjese teksti në skema; duke krahasuar skemat e shkëputura me skemat e njohura për të vlerësuar gabimet gramatikore në pjesën e shkëputur të tekstit; duke përdorur gabimet e burimit në një dokument të caktuar me qëllim mësimin e gramatikës, ku mësimdhënia mund të transmetohet nëpërmjet paraqitjes së shpjegimeve që përfshijnë në shpjegime tekstin fillestar të gabimeve të burimit; dhe marrjen parasysh të gabimeve të mëparshme në burim për të hartuar një udhëzues referues të shkruarit të përshtatur për burimin. Burimi mund të jetë përdorues, mjet, program kompjuterik, e me radhë. Udhëzuesi i të shkruarit mund të mos i referohet një teksti të caktuar. Përmbajtja e udhëzuesit të të shkruarit mund të përzgjidhet bazuar në problemet specifike të shkrimit në burim. Burimi mund të përshtatet për të vlerësuar përmbajtjen brenda udhëzuesit.

Metoda e kontrollit gramatikor mund të përfshijë kryerjen e një analize mbi masën e tekstit; ndarjen e tekstit në skema dhe analizimin e strukturave të ndërtimit gramatikor të tekstit; vlerësimin e cilësisë së tekstit duke krahasuar vlerësimin e gabimit me vlerësime të njohura gabimesh; dhe përcaktimin e një standardi matës shkrimi për tekstin. Burimi i tekstit mund të jetë nga një faqe në internet. Burimi i tekstit mund të jetë rezultat i kërkimit. Vlerësimet e njohura të gabimeve mund të jenë në terma absolute. Masa e tekstit mund të përcaktohet nga një zhanër/lloj i caktuar dhe vlerësimet e njohura të gabimeve të lidhen me atë zhanër/lloj. Masa e tekstit mund të përcaktohet nga një lloj i caktuar burimi dhe vlerësimet e njohura të gabimeve të lidhen me atë lloj burimi. Cilësia e përcaktuar mund të përdoret së paku pjesërisht për të filtruar rezultatet e kërkimit. Mund të dërgohet një sinjal njoftimi bazuar në cilësinë e përcaktuar. Cilësia e përcaktuar mund të përdoret si pragu i pranimit të përmbajtjes për publikim/botim. Vlerësimi mund të përdoret së paku një redaktor (specialist i gjuhës shqipe). Përdorimi i së paku një redaktori mund të menaxhohet nëpërmjet mekanizmave algoritmike të kontrollit. Cilësia e shkrimit mund të jetë treguesi për kategorinë e tekstit. Kategoria mund të jetë mesazhe elektronike “të padëshiruara”(junk), përmbajtje e nxjerrë nga përdoruesi, përmbajtje teksti e shkruar jo mirë për t’u publikuar/botuar si tekst, e me radhë.

Në thelb, metoda e kontrollit gramatikor mund të përfshijë kryerjen e një analize gramatikore në një masë teksti; përcaktimin e një standardi matjeje për cilësinë e shkrimit për tekstin bazuar në analizën gramatikore; dhe manipulimin e rezultateve të kërkimit bazuar në standardin e cilësisë së shkrimit. Burimi i tekstit mund të jetë një rezultat kërkimi. Manipulimi mund të jetë me qëllim filtrimin e rezultateve të kërkimit, renditjen e rezultateve të kërkimit, e me radhë.

Në thelb, sistemi i kontrollit gramatikor mund të përfshijë një funksion kontrolli gramatikor për përcaktimin e cilësisë së përmbajtjes në një pasazh teksti me qëllim dallimin e këtij pasazhi teksti nga së paku një kategori teksti, ku teksti mund t’i jepet funksionit të kontrollit gramatikor, funksioni i kontrollit gramatikor kryen analizën e tekstit për gabime gramatikore, funksioni i kontrollit gramatikor kërkon për të bërë përputhjen e cilësisë së përmbajtjes me atë të së paku një kategorie teksti, dhe nxjerr një sinjal për të rrëfyer përputhjen. Kategoria mund të jetë mesazh elektronik “junk”, përmbajtje e nxjerrë nga përdoruesi, e me radhë. Kategoria mund të jetë përmbajtje teksti e shkruar jo aq mirë sa të mund të publikohet/botohet. Vlerësimi mund të përdoret së paku një redaktor (specialist i gjuhës shqipe). Përdorimi i së paku një redaktori mund të menaxhohet nëpërmjet mekanizmave algoritmike të kontrollit.

Në thelb, metoda e kontrollit gramatikor mund të përfshijë përdorimin e funksionit të kontrollit gramatikor për të kontrolluar nga ana gramatikore një masë teksti të dhënë nga një mjet, me qëllim përmirësimin e saktësisë gramatikore të tekstit; kryerjen e një procesi në funksionin e kontrollit gramatikor, proces i cili përfshin: analizimin e tekstit; ndarjen e tekstit në skema; analizimin e strukturës së ndërtimit gramatikor të tekstit bazuar në këto skema; korrigjimin e gabimeve gramatikore në tekst bazuar në analizën e bërë; pasurimin e tekstit bazuar në krahasimin e skemave të përcaktuara me skemat e njohura; dhe çuarjen e tekstit të korrigjuar dhe pasuruar në mjetin e lëvizshëm/mobile. Mjeti mund të jetë mjet komunikimi i lëvizshëm/mobile, përdorues, marrës i synuar, e me radhë. Mjeti i komunikimit i lëvizshëm/mobile mund të jetë së paku një telefon celular dhe një mjet kompjuterik tablet. Mjeti mund të përdorë njohjen e karaktereve. Mjeti mund të përdorë njohjen/transmetimin nga zëri në tekst. Formatimi i tekstit mund të jetë korrigjimi i tekstit, përmirësimi i tekstit, e me radhë. Veçantitë e mjetit fillestar mund të merren parasysh në korrigjimet e tekstit. Veçantitë e mjetit fillestar mund të merren parasysh në pasurimin e tekstit. Masa e tekstit mund të jetë së paku një mesazh, një mesazh elektronik, një artikull mikro-blogu, një artikull blogu, dhe një postim në rrjet social. Masa e tekstit mund të lidhet me një kategori teksti. Kategoria mund të jetë teknike (mjekësore, financiare, juridike etj.) dhe aty analiza mund të kryhet bazuar në skemat e teksteve teknike. Teksti mjekësor mund të lidhet me një procedurë diagnostikimi, me dhënie e recetës, etj. Kategoria mund të jetë ligjore ku analiza mund të kryhet bazuar në skemat e tekstit ligjor. Teksti ligjor mund të jetë deklaratë e policisë. Teksti i korrigjuar mund të jetë në formën e së paku një mesazhi elektronik dhe tekst me format të thjeshtë proze. Teksti i korrigjuar mund t'i ofrohet burimit në disa formate përhapjeje. Korrigjimi mund të përdorë së paku një redaktor (specialist i gjuhës shqipe). Përdorimi i së paku një redaktori mund të menaxhohet nëpërmjet mekanizmave algoritmike kontrolluese.

Në thelb, sistemi i kontrollit gramatikor mund të përfshijë një funksion kontrolli gramatikor të integruar në një mjedis kompjuterik për të analizuar tekstin e nxjerrë nga mjeti për të parë gabimet gramatikore, ku përdoruesi nxjerr/krijon një tekst të dhënë në mjet, mjeti transmeton tekstin e dhënë drejt funksionit të kontrollit gramatikor, funksioni i kontrollit gramatikor kontrollon tekstin e dhënë për gabime gramatikore dhe nxjerr një tekst të korrigjuar, dhe funksioni i kontrollit gramatikor transmeton tekstin e korrigjuar. Mjeti mund të jetë pajisje komunikimi e lëvizshme/mobile, klient poste elektronike në kompjuter, etj. Mjeti mund të jetë së paku një telefon celular dhe një mjet kompjuterik tablet. Gabimi mund të jetë gabim gramatikor. Gabimi gramatikor mund të jetë gabim formatimi. Korrigjimi i gabimit gramatikor mund të rezultojë në përmirësimin e tekstit. Transmetimi mund të jetë transmetim drejt marrësit të synuar, drejt mjetit, etj. Përdoruesi mund të zgjedhë tekstin e korrigjuar për transmetim. Teksti i dhënë mund të jetë mesazh, mesazh elektronik, artikull mikro-blogu, artikull blogu, postim në rrjet social, etj. Teksti i korrigjuar mund të jetë në formën e së paku një mesazhi elektronik ose tekst i thjeshtë në formatin e prozës. Teksti i korrigjuar mund t'i ofrohet përdoruesit në disa formate përhapjeje.

Këto e të tjera sisteme, metoda, objekte, tipare dhe përparësi të shpikjes aktuale do të jenë të qarta për personat me aftësi në këtë fushë nga përshkrimi me hollësi më poshtë: i *mesazheve grafike* (përdorimi i ngjyrave të ndryshme për të përcjellë renditjen/shkallën dhe llojin e gabimit gramatikor), *mesazheve shpjeguese* me shkrim të karakterit morfologjik, sintaksor, morfologjiko-sintaksor, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit, si dhe *sugjerimet me siguri të lartë* dhe me *siguri të ulët* të ndërthurura me mesazhet grafike (përdorimi i ngjyrave të ndryshme). Të gjitha dokumentet e përmendura këtu janë të ndërthurura në tërësinë e tyre me referencë.

PËRSHKRIM I SHKURTËR I FIGURAVE, MESAZHEVE DHE SUGJERIMEVE

Përmirësimi i metodave dhe sistemeve të kontrollit gramatikor të kësaj shpikje mund të kuptohen më mirë duke iu referuar figurave të mëposhtme, të cilat kategorizohen në pesë grupe kryesore:

1. Morfologjik
2. Morfologjiko-sintaksor
3. Sintaksor

4. Rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit
5. Sugjerim i karakteristik logjik

Për secilin nga kategoritë po ofrojnë një përshkrim të hollësishëm si më poshtë:

1. Morfologjik

FIG. 1 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të plotë, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit morfologjik, e cila nënkupton se fjala nuk gjendet në bazën e të dhënave të normës standarde gjuhësore ose është shkruar gabim.




FIG.1

FIG. 1A përshkruan një sugjerim me siguri të ulët të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit morfologjik, ku funksioni i sugjerimit zbatohet me përafërsi me anë të një algoritmi në një konfigurim hibrid klient-server.




FIG.1A

2. Morfologjiko-sintaksor

FIG. 2 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit morfologjik dhe sintaksor, e cila nënkupton se fjala ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.




FIG.2

FIG. 2A përshkruan një sugjerim me siguri të ulët të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit morfologjik dhe sintaksor, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike




FIG.2A

FIG. 3 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të hollë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit morfologjik dhe sintaksor, e cila nënkupton se fjala ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.3

FIG. 3A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Lakim në formë të pasaktë”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit morfologjik dhe sintaksor, e cila nënkupton se fjala ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund

të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.3A

FIG. 4 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të hollë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit morfologjik dhe sintaksor, e cila nënkupton se fjala ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.4

FIG. 4A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Zgjedhim në formë të pasaktë”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit morfologjik dhe sintaksor, e cila nënkupton se fjala ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.4A

3. Sintaksor

FIG. 5 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një parafjalë (që përbëhet nga një fjalë e vetme apo një togfjalësh) ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.




FIG.5

FIG. 5A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për parafjalët si fjalë të vetme apo që përbëhen nga një togfjalësh në varësi të përdorimit të tyre sipas rasave, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.




FIG.5A

FIG. 6 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një folje (që mund të përbëhet nga një fjalë e vetme apo një togfjalësh) ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.

do te shkruaj një libër të bukur.

FIG.6

FIG. 6A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për foljet si fjalë të vetme apo që përbëhen nga një togfjalësh në varësi të përdorimit të tyre sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.

do te shkruaj një libër të bukur.

Do të

FIG.6A

FIG. 7 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një trajtë e shkurtër, apo trajtë e shkurtër e bashkuar ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë kur ndodhet para një foljeje; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.

Në fillim të marsit dëbora nisi te shkrinte.
Akujt u lëngëzuan mbi çatitë që kullonin si
çezma.

FIG.7

FIG. 7A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për trajtat e shkurtra ose trajtat e shkurtra të bashkuara para foljeve në varësi të përdorimit të këtyre të fundit sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.

Në fillim të marsit dëbora nisi te shkrinte.
Akujt u lëngëzuan mbi çatitë që kullonin si
çezma.

të

FIG.7A

FIG. 8 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një nyjë para mbiemrit ekziston si formë e lejuar morfologjike (një fjalë me funksion të ndryshëm, por jo si nyjë), por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë kur ndodhet para një mbiemri; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.

Do të shkruaj një libër te bukur.

FIG.8

FIG. 8A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për nyjet e lejuara para mbiemrave në varësi të përdorimit të këtyre të fundit sipas trajtës (të shquar dhe të pashquar) numrit (njëjës dhe shumës), rasave të ndryshme dhe formës së lakimit para dhe pas emrit, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.

Do të shkruaj një libër te bukur.

të

FIG.8A

FIG. 9 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një folje (që mund të përbëhet nga një fjalë e vetme apo një togfjalësh) ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.



FIG.9

FIG. 9A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për foljet si fjalë të vetme apo që përbëhen nga një togfjalësh në varësi të përdorimit të tyre sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.



FIG.9A

FIG. 10 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një folje (që mund të përbëhet nga një fjalë e vetme apo një togfjalësh) ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.




FIG.10

FIG. 10A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për foljet si fjalë të vetme apo që përbëhen nga një togfjalësh në varësi të përdorimit të tyre sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.




FIG.10A

FIG. 11 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një folje (që mund të përbëhet nga një fjalë e vetme apo një togfjalësh) ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.



FIG.11

FIG. 11A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për foljet si fjalë të vetme apo që përbëhen nga një togfjalësh në varësi të përdorimit të tyre sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.



FIG.11A

FIG. 12 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë portokalli të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit sintaksor, e cila nënkupton se një folje (që mund të përbëhet nga një fjalë e vetme apo një togfjalësh) ekziston si formë e lejuar morfologjike, por në aspektin sintaksor mund të jetë e pasaktë; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.




FIG.12

FIG. 12A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit sintaksor për foljet si fjalë të vetme apo që përbëhen nga një togfjalësh në varësi të përdorimit të tyre sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me funksione mësimdhënieje automatike.



FIG.12A

4.Rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit

FIG. 13 përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Kjo fjali nuk fillon me shkronjë të madhe”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.13

FIG. 13A përshkruan një sugjerim me siguri të lartë të funksionit të lidhur me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; i cili kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.13A

FIG. 14 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të hollë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.14

FIG. 14A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Gabim i mundshëm: kenë përsëritur një hapësirë”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e

kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.14A

FIG. 15 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të hollë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.15

FIG. 15A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Shto një hapësirë midis fjalive”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.15A

FIG. 16 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të hollë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.16

FIG. 16A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Shtoni shenjën e pikësimit në fund të paragrafit”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.16A

FIG. 17 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të hollë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.17

FIG. 17A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Dy pika njëra pas tjetrës”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.17A

FIG. 18 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të kuqe të hollë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.18

FIG. 18A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit: “Gabim i mundshëm: keni përsëritur një fjalë”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit për rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.18A

5.Sugjerim i karakteristik logjik

FIG. 19 përshkruan një mesazh grafik të paraqitur nga një vijë me ngjyrë të blertë të plotë si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit logjik, i cili nënkupton se nuk kemi të bëjmë me një gabim të karakterit gramatikor (morfologjik, sintaksor si dhe rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit), por të mospërputhjes së të dhënave sipas një funksioni të njohur logjik; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.19

FIG. 19A përshkruan një mesazh me shkrim, i cili jep informacion në lidhje me natyrën e gabimit logjik: “Data 11 tetor 2018 nuk është e hënë, por është e enjte”, si pjesë e funksioneve të lidhura me funksionin e kontrollit logjik; ky funksion kryhet nëpërmjet motorrit të përpunimit të tekstit me ndërveprim me një përdorues.




FIG.19A

Ndërkohë që shpikja është përshkruar më sipër, duke përzgjedhur disa nga kontrollat më të shpeshta gramatikore, funksionet e tjera do të kuptoheshin lehtësisht edhe nga redaktorët përdorues me aftësi të zakonshme në këtë fushë, të cilat përfshihen po këtu.

PRETENDIMET

Pretendohet si më poshtë:

1. Një metodë për kontroll gramatikor, metodë e cila përmban: marrjen e tekstit nëpërmjet një rrjeti komunikimi në një mjet të parë kompjuterik me funksion kontrolli gramatikor nga një pajisje e dytë kompjuterike, ku funksioni i kontrollit gramatikor zbulon në mënyrë automatike një numër gabimesh të mundshme gramatikore në tekst nëpërmjet algoritmeve të programit kompjuterik dhe e kategorizon numrin e zbuluar të gabimeve të mundshme gramatikore si së paku një gabim i mundshëm me siguri të lartë dhe një gabim i mundshëm me siguri të ulët, ku gabimi i mundshëm me siguri të lartë konsiderohet gabimi i identifikuar dhe gabim i mundshëm me siguri të ulët është ai, të cilin funksioni i kontrollit gramatikor nuk mund ta përcaktojë si ekzistues me siguri mjaftueshëm të lartë; dhënie, në mënyrë automatike nga mjeti i parë kompjuterik me funksion kontrolli gramatikor nëpërmjet rrjetit të komunikimeve, secilit prej numrit së pajisjeve kompjuterike të redaktorëve nga një numër redaktorësh në një grup burimesh, së paku një pjesë përkatëse të tekstit që përmban një gabim të mundshëm gramatikor të kategorizuar si gabim i mundshëm me siguri të ulët si rezultat i zbulimit automatik nga funksioni i kontrollit gramatikor, në mënyrë që të kryhet një proces i përbashkët më i gjerë për kapjen e gabimit në pjesën e tekstit nga një numër redaktorësh paralelisht për ato gabime gramatikore që kategorizohen si gabime të mundshme me siguri të ulët, për të përcaktuar nëse ekziston në të vërtetë një gabim apo jo, ku gabimi i përcaktuar nga redaktori (përdorues) do të jetë gabim i vërtetë, i cili mund të korrigjohet nga përdoruesi për të nxjerrë një rezultat korrigjimi ose i dërgohet sërish funksionit të kontrollit gramatikor për korrigjim automatik ose për shpërndarje si gabim i identifikuar të së paku një përdorues; ku funksioni i kontrollit gramatikor mund të korrigjojë automatikisht së paku disa prej gabimeve të identifikuar për të nxjerrë pjesë tekstesh të korrigjuara; menaxhimin, nga funksioni i kontrollit gramatikor, e shpërndarjes automatike të së paku disa prej gabimeve të identifikuar drejt masës së përdoruesve, në mënyrë që të kryhet bashkërisht korrigjimi i zgjeruar gramatikor nga redaktorët specialistë dhe paralelisht nga masa e përdoruesve për të nxjerrë rezultate korrigjimi, ku secili prej masës të përdoruesve është i lidhur me një renditje dhe merr së paku një pjesë përkatëse nga teksti që përmban një gabim të identifikuar bazuar në renditjen që i është lidhur dhe ku secili prej masës së mjeteve kompjuterike të përdoruesve është i shkëputur nga mjeti i parë kompjuterik dhe mjeti i dytë kompjuterik; marrjen, nga funksioni i kontrollit gramatikor, të rezultateve të korrigjimit nga masa e përdoruesve dhe përfshirjen automatike të rezultateve të korrigjimit në secilën prej pjesëve të korrigjuara automatikisht të teksteve në funksionin e kontrollit gramatikor për të kontribuar në së paku një version të korrigjuar të tekstit të marrë; dhe dërgimin e së paku një versioni të korrigjuar sërish të mjeti i dytë kompjuterik.

2. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku mjeti i dytë kompjuterik ndërvepron/lidhet (ndërfaqja) me funksionin e kontrollit gramatikor nëpërmjet një ndërfaqeje programimi me aplikacion (application programming interface).

3. Metoda e pretendimit të 2-të, ku mjeti i dytë kompjuterik është server (enterprise server) dhe serveri mban një shërbim me akses në internet të funksionit të kontrollit gramatikor nëpërmjet ndërfaqjes së programimit me aplikacion.

4. Metoda e pretendimit të 2-të, ku ndërfaqja e programimit me aplikacion lidhet me së paku një aplikacion të palës së tretë, një përpunues fjalësh, një faqe kërkimi në internet, një motor kërkimi, një klient poste elektronike, një aplikacion mesazhesh, një aplikacion blogu, një aplikacion mikro-blogu, një funksion për menaxhimin e përmbajtjes, një funksion publikimi/botimi dhe një funksion reklamimi.

5. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një version i korrigjuar përfshin një numër pjesësh të korrigjuara të integruara sërish në tekstin e marrë në fillim dhe ku mjeti i dytë kompjuterik merr të gjithë tekstin me gabimet e korrigjuara.

6. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej pjesëve të tekstit i jepet palës korresponduese në masën e redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim në një prej formateve me zgjedhje dhe formateve me përgjigje të shkurtra.
7. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej pjesëve të tekstit që përmban gabim të identifikuar ose gabim të mundshëm gramatikor u jepet së paku dy prej numrit të redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim dhe, nëse vlerësimet që ata sjellin nuk përputhen, atëherë së paku njëri version i tekstit të korrigjuar përfshin vlerësimin e redaktorit të renditjes më të lartë prej së paku dy prej numrit të redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe).
8. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej pjesëve të tekstit që përmban gabim të identifikuar u jepet së paku disave prej numrit të redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim të gabimit si mënyrë për të dhënë informacion të mëtejshëm për renditjen cilësore të redaktorëve.
9. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku renditja përkatëse e secilit prej redaktorëve bazohet në së paku një prej saktësive të përgjithshme në korrigjimin e gabimeve, në aftësinë për lloje të caktuara gabimesh, në kohë, të qëniet në dispozicion dhe në kosto.
10. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një version i korrigjuar është version i nënvizuar me të kuqe.
11. Metoda e pretendimit të 1-rë, që përfshin më tej zbulimin, nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe), e gabimeve të tjera gramatikore që nuk janë gjetur nga zbulimi automatik i funksionit të kontrollit gramatikor në morinë e gabimeve të mundshme gramatikore, dhe korrigjimin, nga numri i redaktorëve, e gabimeve të tjera gramatikore si edhe numrin e gabimeve gramatikore të kategorizuara si gabime të mundshme me siguri të ulët të zbuluara prej funksionit të kontrollit gramatikor.
12. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve është mjet kompjuterik i lëvizshëm (mobile).
13. Një sistem kontrolli gramatikor, sistem që përmban: funksion kontrolli gramatikor në një mjet kompjuterik të integruar në një mjedis kompjuterik, për të analizuar tekstin e nxjerrë nga një mjet kompjuterik i dytë i shkëputur, për të parë gabimet gramatikore, ku mjeti i dytë kompjuterik ia transmeton tekstin funksionit të kontrollit gramatikor nëpërmjet një rrjeti komunikimesh, dhe funksioni i kontrollit gramatikor zbulon në mënyrë automatike një numër gabimesh të mundshme gramatikore në tekst nëpërmjet algoritmeve të programimit kompjuterik, e kategorizon secilin prej numrit të kapur të gabimeve të mundshme si një prej së paku gabim i mundshëm gramatikor me siguri të lartë dhe një gabim i mundshëm me siguri të ulët, ku gabim i mundshëm me siguri të lartë konsiderohet gabimi i identifikuar dhe gabim i mundshëm me siguri të ulët është gabimi të cilin funksioni i kontrollit gramatikor nuk mund ta përcaktojë dot nëse ekziston me siguri mjaftueshëm të lartë, dhe dërgon automatikisht drejt secilit prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve përdorues në një popullsi burimesh, së paku një pjesë përkatëse të tekstit që përmban së paku një prej numrit të gabimeve të mundshme gramatikore të kategorizuara si gabim i mundshëm me siguri të ulët në mënyrë që të kryhet një proces i përbashkët më i gjerë për kapjen e gabimit në pjesën e tekstit nga një numër redaktorësh paralelisht për ato gabime gramatikore të kategorizuara si gabime të mundshme me siguri të ulët, për të përcaktuar nëse ka me të vërtetë gabim, ku gabimi i përcaktuar nga redaktori (specialist i gjuhës shqipe) që është gabim me të vërtetë mund të korrigjohet nga redaktori përdorues për të nxjerrë rezultatin e korrigjimit ose i dërgohet sërish funksionit të kontrollit gramatikor për korrigjim automatik ose për shpërndarje si gabim i identifikuar të së paku një prej redaktorëve (specialist të gjuhës shqipe), ku funksioni i kontrollit gramatikor menaxhon shpërndarjen automatike të së paku disa prej gabimeve të identifikuara të numrit të përdoruesve, në mënyrë që korrigjimi njerëzor gramatikor i zgjeruar të kryhet paralelisht në mënyrë të përbashkët nga numri i redaktorëve për të nxjerrë rezultatet e korrigjimit, ku secili prej numrit të redaktorëve lidhet me një renditje cilësore dhe merr së paku një pjesë përgjegjëse të tekstit që përmban gabim të identifikuar bazuar në renditjen cilësore që i është caktuar, dhe ku secili prej mjeteve kompjuterike të përdoruesve është i veçuar nga mjeti i parë kompjuterik dhe mjeti i dytë kompjuterik, ku rezultatet e korrigjimit të kontrollit gramatikor të zgjeruar nga përdoruesi nga numri i redaktorëve merren nga funksioni i kontrollit gramatikor dhe përfshihen në mënyrë automatike me çfarëdo pjese teksti të korrigjuar në mënyrë automatike të funksionit të kontrollit gramatikor për të kontribuar në një version të

korrigjuar të tekstit të marrë, dhe ku së paku një version i korrigjuar i dërgohet sërish mjetit të dytë kompjuterik.

14. Sistemi i pretendimit të 13-të, ku mjeti i dytë kompjuterik është server (enterprise server).

15. Sistemi i pretendimit të 14-të, ku serveri (enterprise server) mban një shërbim të aksuesueshëm në rrjet të funksionit të kontrollit gramatikor, ku mjeti i dytë kompjuterik ia transmeton tekstin funksionit të kontrollit gramatikor nëpërmjet një ndërfaqjeje programimi me aplikacion.

16. Sistemi i pretendimit të 13-të, ku ndërfaqja programuese me aplikacion lidhet me së paku një prej aplikacioneve të palës së tretë, përpunues fjalësh, një faqe kërkimi në internet, motor kërkimi, klient poste elektronike, aplikacion mesazhesh, aplikacion blogu, aplikacion mikro-blogu, funksion të menaxhimit të përmbajtjes, funksion publikimi/botimi dhe funksion reklamimi.

17. Një metodë kontrolli gramatikor, metodë e cila përmban: marrjen e teksteve nëpërmjet rrjetit të komunikimeve prej funksionit të kontrollit gramatikor të vendosur në një pajisje kompjuterike nga një mjet i dytë kompjuterik, ku funksioni i kontrollit gramatikor zbulon në mënyrë automatike një numër gabimesh të mundshme gramatikore në tekst nëpërmjet algoritmeve të programit kompjuterik, kategorizon secilin prej gabimeve gramatikore të numrit të zbuluar të gabimeve të mundshme gramatikore si një, së paku, gabim i mundshëm me siguri të lartë dhe një gabim i mundshëm me siguri të ulët, ku gabim i mundshëm me siguri të lartë konsiderohet gabimi i identifikuar dhe gabim i mundshëm me siguri të ulët si një që funksioni i kontrollit gramatikor nuk mund ta përcaktojë ekzistues me siguri mjaftueshëm të lartë; transmetimin në mënyrë automatike të secilit prej numrit të gabimeve të mundshme gramatikore të kategorizuara si gabime me siguri të ulët nga funksioni i kontrollit gramatikor nëpërmjet rrjetit të komunikimeve drejt një numri mjetesh kompjuterike të përdoruesve të një numri redaktorësh në një popullsi burimesh, ku gabimet gramatikore të kategorizuara si gabime me siguri të ulët shpërndahen paralelisht mes numrit të mjeteve kompjuterike të përdoruesve, ku secili prej numrit të gabimeve të mundshme gramatikore kategorizuar si gabim me siguri të ulët i transmetohet së paku njërit prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve për identifikimin e gabimit, ku funksioni i kontrollit gramatikor nuk mund ta përcaktonte nëse kishte gabim apo jo me siguri mjaftueshëm të lartë, ku së paku një prej gabimeve të mundshme gramatikore kategorizuar si gabime me siguri të ulët transmetohet në së paku dy redaktorë nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim, ku një prej së paku dy redaktorëve kryen identifikimin e gabimit dhe një prej së paku dy prej redaktorëve kryen korrigjimin e gabimit, ku gabimet e identifikuara korrigjohen nga së paku një prej funksioneve të kontrollit gramatikor për të nxjerrë pjesët e korrigjuara të tekstit dhe së paku një prej numrit të redaktorëve të nxjerrë rezultatet e korrigjimit, dhe ku secili prej mjeteve kompjuterike të redaktorëve është i veçuar nga mjeti i parë kompjuterik dhe mjeti i dytë kompjuterik; marrjen, nga funksioni i kontrollit gramatikor, e çfarëdo rezultati korrigjimi nga numri i redaktorëve dhe përfshirjen e çfarëdo rezultati korrigjimi nga numri i redaktorëve në cilëndo pjesë teksti të korrigjuar të funksionit të kontrollit gramatikor për të kontribuar në versionin e korrigjuar të tekstit, ku secili prej numrit të redaktorëve lidhet me një renditje cilësie të kontrollit gramatikor, dhe nëse vlerësimi rezultues i së paku dy redaktorëve nuk përputhet, atëherë versioni i korrigjuar i tekstit përfshin vlerësimin e redaktorit që ka renditjen më të lartë; dhe transmetimin e tekstit të korrigjuar të mbledhur drejt mjetit të dytë kompjuterik.

18. Metoda e pretendimit të 17-të, që përfshin më tej zbulimin, nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe), e gabimeve të tjera gramatikore që nuk janë gjetur në zbulimin automatik të funksionit të kontrollit gramatikor në numrin e gabimeve të mundshme gramatikore, dhe korrigjimin, nga numri i redaktorëve, e gabimeve të tjera gramatikore përveç korrigjimit të numrit të gabimeve gramatikore të kategorizuara si gabime të mundshme me siguri të ulët të zbuluara nga funksioni i kontrollit gramatikor.

19. Metoda e pretendimit të 17-të, ku së paku një prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve është mjet kompjuterik i lëvizshëm (mobile).

20. Metoda e pretendimit të 17-të, ku një përdorues i mjetit të dytë kompjuterik ka vendosur më parë tekstin e marrë në mjetin e dytë kompjuterik.

21. Metoda e pretendimit të 20-të, ku përdoruesi i mjetit të dytë kompjuterik ka vendosur tekstin e marrë nëpërmjet së paku një prej veprimeve të drejtpërdrejta si shtypjes, ngarkimit dhe kopjimit dhe ngjitjes në një aplikacion në mjetin e dytë kompjuterik.

22. Metoda e pretendimit të 20-të, ku përdoruesi ka vendosur tekstin e marrë nëpërmjet një ndërfaqjeje programimi me aplikacion (API) të lidhur me funksionin e kontrollit gramatikor.
23. Metoda e pretendimit të 17-të, që përmban më tej kontrollin gramatikor të tekstit të korrigjuar të mbledhur përpara transmetimit të tekstit të korrigjuar të mbledhur në mjedin e dytë kompjuterik.
24. Metoda e pretendimit të 23-të, ku kontrolli gramatikor i tekstit të korrigjuar të mbledhur bëhet së paku pjesërisht nga funksioni i kontrollit gramatikor.
25. Metoda e pretendimit të 23-të, ku kontrolli gramatikor i tekstit të korrigjuar të mbledhur bëhet së paku pjesërisht nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe).
26. Metoda e pretendimit të 23-të, ku numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) monitorohet mbi cilësinë e redaktimit, për të përditësuar renditjen përkatëse të redaktorëve.
27. Metoda e pretendimit të 26-të, ku cilësia e përcaktuar e redaktimit për një redaktor përcakton llojin e gabimit të zbuluar që i transmetohet në vijim redaktorit.

(22) 22/11/2018

(21) AL/P/ 2018/811

(54) **Transportues shërbimesh**

(30) 202016000102795 13/10/2016 IT

(71) Leonardo Bizzocco

rr. Via Professor Giuseppe Scalera, IT

(72) Leonardo Bizzocco (rr. Via Professor Giuseppe Scalera, 32, Itali, Bari)

(57)

Abstrakti:

Ideja inovative që ne synojmë të promovojmë dhe zbatojmë i referohet shpërndarjes së shërbimeve komunale në urbane dhe/ose ekurbane.

qendrat duke përdorur një qendër të vetme shumë-shërbimesh, të quajtur "TRANSPORTUES I SHËRBIMIT ". Ofruesit e shërbimeve, zakonisht, në shumicën

vendet, miratojnë një metodologji të përbashkët për instalimin e shërbimeve, me anë të kanalizimit nëntokësor, duke ndarë

çdo tub ose shërbim pa respektuar ndonjë kriter specifik, shpesh duke i zbritur hapësirën ofruesve të tjerë. Ky lloj instalimi

sistemi nuk merr parasysh pasojat e fatkeqësive natyrore, për shkak të ndërtimit të egër të ndërtesave që parandalojnë ujërat e shiut

nga rrjedhja në kanalet e tij natyrore, nga rrjedhja e sipërme në rrjedhën e poshtme. Konkretisht, duke qenë se uji është një element i pakthyeshem, është

të nevojshme për ta përcjellë atë në respekt të sigurisë së qyteteve dhe vendeve dhe për të parandaluar paqëndrueshmërinë hidrogeologjike. E reja

Transportuesi i shërbimeve mund të zgjidhë të gjitha problemet e sigurisë që vijnë nga shtimi i përmbytjeve të rrugëve për shkak të shpërthimeve të reve dhe

lumenjtë e tejmbushur. Sistemi përcjell në mënyrë racionale ujin e bardhë, ujërat e zeza dhe mbetjet e vajrave të gatimit, duke siguruar shpërndarjen

të shërbimeve parësore GAZ, UJI, ENERGJIA, LINJA TELEFONIKE, FIBRA OPTIKE, KABLLOJT TV, TUBAT E NXEHJES DHE

Mbeturinat e vajrave të gatimit - edhe në kushte të pafavorshme (p.sh.: tërmete)

Transportuesi i shërbimeve përbëhet nga blloqe betoni të armuar ose PVC të rënda (ose blloqe të bëra nga çdo material tjetër me karakteristika të ngjashme), të cilat janë përbërës të parafabrikuar modularë të vendosur nën nivelin e tokës. Këto blloqe, të montuara së bashku me një sistem bashkimesh me vrima të zgjatura (shih vizatimin fig. 3), krijojnë një kanal të pandërprerë të ngjashëm me një tunel për të përcjellë ujë dhe shiut në rrugë. Për më tepër, dimensionet e kanalit do të jenë të përshtatshme për njerëzit në mënyrë që të lejojnë kalimin e teknikëve - Tekniku i mirëmbajtjes/Instaluesi - të cilët mund të hyjnë nga një bllok i veçantë aksesit. Baza e këtij blloku të hyrjes ka një trotuar me rrjetë prej metali të automjetit për aksesin e sigurt të personelit (shih vizatimin fig. 2).

Në pjesën e poshtme të blloqeve ndodhet boshti kryesor për grumbullimin e ujërave të ndotura, i pajisur me hapje në të dyja anët për të lejuar rrjedhjen e ujërave të zeza, me anë të tubacioneve bashkuese dhe sifonëve që vijnë nga ndërtesat civile dhe publike (shih vizatimin fig. 3).

Nëse është e nevojshme, është e mundur të futet një kanal tjetër grumbullues për mbetjet e vajrave të gatimit paralelisht me boshtin kryesor të depozitimit të ujërave të zeza.

Pjesa e sipërme e bllokut do të mbyllet me mbulesë betoni të përforcuar me një trashësi të përshtatshme të nevojshme për një mbyllje të sigurt (shih vizatimin Fig. 3) dhe për strehimet e papërshkueshme nga uji të ndërmarrjeve (të futura në betonin e derdhur) pasi ato janë të papajtueshme me ujë. Shërbimet, si linjat e energjisë elektrike, linjat e ndriçimit urban, linjat telefonike civile, linjat telefonike shtetërore, fibrat optike dhe kabllot televizive dhe/ose kabllot e tensionit të ulët, janë të kanalizuar dhe të pajisura me kuti bashkimi të pavarura (shih vizatimin Fig. 3).

Për një aktivitet më të shpejtë të përcjelljes së ujit të shiut, mendojmë të vendosim disa grila metalike në qendër të bllokut - pikërisht në mbulesë - në nivelin e sipërfaqes së rrugës me një pjerrësi drejt qendrës së rrugës, në mënyrë që uji të mund drejtpërdrejt rrjedhin në kanal dhe të dedikuar të sistemit (shih vizatimin fig. 1). Në rast se duhet të përdorim metodën e vjetër për përcjelljen e ujërave të shiut me pjerrësi të rrugës me shalë, ne do të vendosim disa aksesore hapës në skajet e trotuareve me kanale lidhëse me transportuesin.

Brenda kanalit të inspektimit/mirëmbajtjes (tunelit), në pjesën e sipërme, do të vendosen boshtet kryesore të ndërmarrjeve nën presion - GAZ, UJI I PIJSHËM dhe shërbime të tjera eventuale - të lidhura me kanalet kyçëse "T" në anën e djathtë dhe të majtë. anë, për shpërndarjen e të dy anëve pajisur me valvola mbyllëse të shërbimeve (shih vizatimin Fig. 3).

Mbylljet e kanaleve janë hermetike dhe jashtëzakonisht të sigurta falë guarnicioneve prej gome ose materialeve të ngjashme, si Waterstop ose goma e vullkanizuar.

Mbi të gjitha, Transportuesi i Shërbimeve Komunale, është në gjendje t'i rezistojë tërmeteve, duke siguruar furnizim pa ndërprerje të shërbimeve. Gjithashtu kanalet dhe totalisht të ruajtura nga veprimi gërryes i materialeve oksiduese (tokë, argjilë, rërë, etj.).

Personeli i mirëmbajtjes mund të kryejë me shpejtësi riparimet, duke zvogëluar numrin e kantierëve të punës (gërmime dhe copëza asfalti), të cilat kushtojnë shumë dhe pengojnë qarkullimin e trafikut me kohë të gjata riparimi.

PRETENDIMET

1) Blloqet e "UTILITY CONVEYOR Transportues shërbimesh" janë përbërës të parafabrikuar modularë të bërë nga betoni ose PVC e rëndë - ose çdo material tjetër me të njëjtat karakteristika - për të siguruar rezistencë ndaj ujit dhe qëndrueshmëri.

2) Madhësia e blloqeve do të ndryshojë në varësi të madhësisë së rrugëve, por mbi të gjitha sipas përlllogaritjeve që do të bëjë çdo inxhinier apo projektues në ndërtim.

